VENDIM
Nr. 111, datë 1.10.2013

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "WONDER" SHA PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT DHE TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA SHOQËRIA "WONDER POWER" SHA TE SHOQËRIA "BHP ENERGY" SHPK

Në mbështetje të nenit 9 dhe 20 pika 1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 17 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", pikës 1.3 të licencës së aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e datës 1.10.2013, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë "Wonder Power" sh.a., shoqërisë "BHP Energy" sh.p.k.
2. Të fillojë procedurat për transferimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë "Wonder Power" sh.a., shoqërisë "BHP Energy" sh.p.k.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e shoqërive "Wonder" sh.a., "Wonder Power" sh.p.k. dhe "BHP Energy" sh.p.k. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo